

**VENDIM**  
**Nr. 669, datë 30.10.2024**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 639, DATË 6.11.2017, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË  
AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS, AKREDITUAR  
NGA BASHKIMI EVROPIAN, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të pikës 4, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në pikën 2, të vendimit nr. 639, datë 6.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, organika e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, zëvendësohet me organikën sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**

Skema 2

**ORGANIKA E AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË  
ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN**

| NR                | POZICIONI                                      | KATEGORIA | NUMRI |
|-------------------|------------------------------------------------|-----------|-------|
| I.                | Drejtor i Përgjithshëm                         | I-3       | 1     |
| II.               | Zëvendësdyrëtor i Përgjithshëm                 | II-1      | 1     |
| III.              | Drejtoria e Auditimit të Programeve IPA        |           | 7     |
|                   | Drejtör                                        | II-1      | 1     |
|                   | Auditues i Parë                                | II-1      | 3     |
|                   | Auditues i Dytë                                | III-1     | 3     |
| IV.               | Drejtoria e Auditimit të Programeve IPARD      |           | 7     |
|                   | Drejtör                                        | II-1      | 1     |
|                   | Auditues i Parë                                | II-1      | 4     |
|                   | Auditues i Dytë                                | III-1     | 2     |
| V.                | Drejtoria e Financës dhe Juridikë              |           | 7     |
|                   | Drejtör                                        | II-2      | 1     |
|                   | Sëktori i Financës dhe Administratës           |           | 3     |
|                   | Përgjegjës Sëktori                             | III-2     | 1     |
|                   | Specialist (Buxhet/Financë)                    | IV-2      | 1     |
|                   | Specialist (Buxime Njerëzore/ Arkiv Protokoll) | IV-2      | 1     |
|                   | Sëktori Juridik dhe Marrëdhëniet me Jashtë     |           | 3     |
|                   | Përgjegjës Sëktori                             | III-2     | 1     |
|                   | Specialist (Jurist)                            | IV-2      | 1     |
|                   | Specialist (Marrëdhëniet me Jashtë)            | IV-2      | 1     |
| Punonjëë gjithsej |                                                |           | 23    |